



Almetaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 48, datë 27.1.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT DHE RIKONSTRUKSIONIT/RIFORCIMIT
TË OBJEKTEVE NË ADMINISTRIM TË SHËRBIMIT INFORMATIV
TË SHETIT, NË BASHKITË DURRËS DHE LEZHË, DHE ÇAKTIMIN
E SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHETIT SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarjet "i" e "iii", 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit, të ndodhura në bashkitë Durrës dhe Lezhë, në masën 21 586 378 (njëzet e një milionë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, sipas detajimit të mëposhtëm:
 - a) Rindërtimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Durrës, në masën 17 402 445 (shtatëmbëdhjetë milionë e katërqind e dy mijë e katërqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH;
 - b) Rikonstruksioni/riforcimi i objektit në administrim të Shërbimit Informativ të Shtetit (SHISH), të ndodhur në Bashkinë Lezhë, në masën 4 183 933 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e tre mijë nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2. Shërbimit Informativ të Shtetit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i shtohet fondi në masën 7 220 733 (shtatë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit dhe rikonstruksionit/riforcimit të objekteve, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i detajuar, si më poshtë vijon:
 - a) Në masën 5 220 733 (pesë milionë e dyqind e njëzet mijë e shtatëqind e tridhjetë e tre) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të objektit në administrim, të ndodhur në Bashkinë Durrës;
 - b) Në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit/riforcimit të objektit, të ndodhur në Bashkinë Lezhë.
3. Caktimin e Shërbimit Informativ të Shtetit si njësi zbatuese për rindërtimin dhe rikonstruksionin/riforcimin e objekteve, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

EDIRAMA

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT.540/1
DATE 23 - 11.2021

MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE
EKONOMISË
SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI

